

Logo e shitesit



KONTRATË

PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË BALANCIMIT (Kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) NDËRMJET SHOQËRIVE OST SH.A. DHE

Sot në datë __. __. 20 __, duke u mbështetur në vullnetin e lirë të:

- **Operatori i Sistemit të Transmetimit**, (me poshte referuar si OST sh.a), shoqëri aksionere, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. 31935, dt. 14.07.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, me adresë: Autostrada Tiranë –Durrës, Km 9, Yrshek, Kashar, Tiranë., Shqipëri, me NIPT K42101801N, përfaqësuar nga **Z. Skerdi DRENOVA Administratori i OST sh.a.**, (këtu më poshtë referuar si “**Bleresi**” dhe
- (2), një shoqëri me seli të regjistruar në adresën....., Tiranë, me NIPT , i përfaqësuar nga, (këtu poshte referuar si “**Shitësi**”)

secila referuar sipas marreveshjes gjithashtu si “**Pala**” ose së bashku “**Palët**” sipas rastit, bien dakord si me poshte:

Baza ligjore:

- Ligji Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
- Vendimi i Bordit të ERE nr. 106, datë 02.07.2020 “Mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”;
- Vendimi i Bordit të ERE Nr. 186 datë 10.11.2017 “Mbi miratimin e Kodit të Transmetimit”;
Vendimi i Bordit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.”;

- Vendimi i Bordit të ERE nr. 134, datë 06.09.2017 “Mbi Licencimin e Shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit “OST” sh.a., në aktivitetin e Operimit Të Sistemit Të Transmetimit të Energjisë Elektrike. “

Neni 1

Përkufizime

Përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë kontratë ose kur konteksti e kërkon ndryshe, të gjithë termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e përcaktuar në këto përkufizime:

“Kontratë” do të thotë kjo kontratë dhe të gjitha ndryshimet që mund ti bëhen kësaj kontratë së bashku me anekset dhe çdo dokumentacioni bashkëlidhur.

“Data e fillimit” do të thotë dita nga e cila kontrata fillon të bëhet efektive.

“Muaji” do të thotë muaji kalendarik.

“Viti” do të thotë viti kalendarik.

“Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a ose “OST” është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të Sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike..

“Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE“, është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë dhe ligjin për sektorin e gazit.

“Sistem i Transmetimit” është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vëndeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçës për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

“Sistemi i energjisë elektrike” është një Sistem i ndërlidhur, i përbërë nga Centralet Elektrike, linjat elektrike, nënstacionet dhe pajisjet e Transmetimit dhe Shpërndarjes me qëllim transmetimin apo shpërndarjen e Energjisë Elektrike te klientët.

“Pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike” është një person juridik, i regjistruar si pjesëtar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe operatorin e tregut. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

“Rezerva e mbajtjes së frekuencës (FCR)” njihet si (rezerva e rregullimit primar). Është ajo rezervë që në rast të devijimit të frekuencës nga vlerat e lejuara, aktivizohet automatikisht dhe plotësisht brenda 30 sec, duke vazhduar të jetë efektive për rreth 15 min, nëpërmjet kontrollit automatik RASH (Rregullatori Automatik i Shpejtësisë) të çdo agregati që mbahet vazhdimisht në punë.

“Rezerva e restaurimit të frekuencës (FRR)” është rezerva e rivendosjes së frekuencës, njihet si (rezerva e rregullimit sekondar). Nënkupton rezervat e fuqis aktive në dispozicion për të rivendosur frekuencën e sistemit në frekuencën nominale. Kjo rezerve mund të aktivizohet në mënyrë automatike (aFRR) ose manuale (mFRR).

FRR automatike (aFRR) - do të thotë FRR që mund të aktivizohet nga një pajisje automatike e kontrollit.

FRR manuale (mFRR) - do të thotë FRR që mund të aktivizohet në mënyrë manuale nga OSHB pas marrjes së urdherit nga qendra kombëtare Dispecer.

“Rezerva zëvendësuese (RR) njihet si (rezerva e rregullimit terciar) “ është rezerva e rregullimit terciar e cila aktivizohet manualisht sipas kërkesës së Operatorit të Transmetimit, në rast se vihet re aktivizim i vazhdueshëm i rezervës FRR deri në limitet e paracaktuara. Qellimi kryesor i rezervës terciare është të clirojë rezervën FRR dhe ta kthejë në gatishmëri për aktivizimin e radhës, si dhe të përdoret si rezervë suplementare për rezervën FRR kur shfaqet një incident në sistemin elektroenergjetik. Koha e aktivizimit të rezervës RR është 15 min nga kërkesa e bërë nga operatori i QDK.

Kapaciteti rezervë - nënkupton sasinë e FCR, FRR ose RR që duhet të jetë e disponueshme për OST në ngritje/ulje.

“Forcë madhore”, nënkupton një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë OSHB të përmbushë detyrimet e tij sipas marrëveshjes, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm njerëzor dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe OSHB nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

PShD (Periudhë e Shlyerjes së Disbalancave)

“Rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike” Rregullat për tregun balancues miratuar me Vendimi i Bordit të ERE nr. 106, datë 02.07.2020 “Mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”.

“Tregu Balancues i Energjisë Elektrike” një treg i operuar nga OST në përputhje me “Rregullat për tregun Shqiptar të balancimit”.

“Shërbime Ndihmëse” janë shërbimet e nevojshme për operimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes.

“Shërbimi i Balancimit” është sigurimi i kapacitetit rezervë të kontraktuar dhe energjia respektive e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.

“Ofruesi i shërbimit të balancimit”- është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike që siguron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, në bazë të një kontrate për pjesëmarrje në tregun e balancimit, në përputhje me rregullat e balancimit të sistemit elektroenergjetik.

“Përfaqësues i Autorizuar” është person i ngarkuar zyrtarisht nga Përfaqësuesi Ligjor i shoqërive OST sh.a dhe për te garantuar zbatimin e kësaj Kontrate.

“Urdhër Operativ” është urdhër që jepet nga Qendra Dispeçer e OST në përputhje me këtë kontratë dhe i detyrueshëm për t’u zbatuar nga Qendra Dispeçer e Këto urdhëra jepen nëpërmjet telefonit të dedikuar me regjistrim, fonogrameve, faksit dhe mesazheve kompjuterike prej instalimeve SCADA të Sistemit Elektroenergjetik.

“Veprim Operativ” është veprimi që ndërmerret nga Qendra Dispeçer e për zbatimin e urdhërit operativ të lëshuar nga Qendra Dispeçer e OST në përputhje me këtë kontratë.

Neni 2

Objekti i kontrates

1. Kjo Kontratë (e cila përfshin Shtojcën 1, Shtojcën 2 dhe Aneksin/et) rregullon marrdhëniet midis Palëve për secilin prej ofrimeve të shërbimit të balancimit (Kapacitet rezervë dhe energjisë balancuese) që do të përdoret për balancimin e sistemit elektroenergjetik sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.
2. Kjo kontratë nënshkruhet vetëm një herë para hyrjes në procedurën e parë të prokurimit të vitit kalendarik përkatës në të cilin merr pjesë.
3. Për çdo blerje që do të bëhet gjatë kohështirjes së kësaj kontrate, për procedurën përkatëse të prokurimit në të cilën shitësi do të shpallet fitues, do të nënshkruhet nga të dyja palët vetëm Aneksi përkatës sipas nenit 2 të kontratës.
4. Të gjithë anekset që do të nënshkruhen midis palëve gjatë kohështirjes së kësaj kontrate përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate.
5. Aneksi/et nuk do të ndryshoj/në kushtet e kësaj kontrate dhe do të hartohet/en sipas te gjitha përcaktimeve te bera ne të, në lidhje me objektin e shitjes, lëshimin e faturës, mënyrën dhe afatet e pagesës, etj.
6. Palët e Marrëveshjes bien dakord që moszbatimi i detyrimeve të një pale mbi secilën prej anekseve përbën shkelje të kontratës dhe rregullohet sipas nenit 12 të saj.

Neni 3

Sasia dhe Çmimi i kontraktuar

1. Sasia dhe çmimi i kapacitetit rezervë të kontraktuar dhe energjisë balancuese të aktivizuar që Shitësi do ti livrojë Blerësit, sipas ofertës së pranuar nga bleresi në rastin e kapacitetit rezervë dhe sipas sasisë së aktivizuar dhe çmimit të rezultuar nga tregu të energjisë balancues në procedurat përkatëse të prokurimit, do të specifikohet sipas programit të dhënë në Aneksin që do të firmoset nga palët pas perfundimit të çdo procedure blerje.
2. Modeli i aneksit për kapacitetin rezervë përcaktohet në shtojcën 1 të kësaj kontrate, ndërsa modeli i aneksit për energjinë balancuese përcaktohet në shtojcën 2 të kësaj kontrate.
3. Anekset që do të nënshkruhen brenda 1 viti kalendarik do të numertohen në mënyrë kronologjike duke filluar nga numri 1.

Neni 4

Detyrimet dhe te Drejtat e OST sh.a.

1. OST është përgjegjëse për dimensionimin, prokurimin, kontraktimin dhe aktivizimin e shërbimeve balancuese në mënyrë që të ruajë balancën e sistemit.
2. Në rastin e disbalancës së sistemit OST ka të drejtë të aktivizojë shërbimet balancuese nga OShB e kontraktuar, deri në rivendosjen e balancës në sistem.
3. OST sha është përgjegjëse për minimizimin e kostos së prokurimit të shërbimit të balancimit duke kontraktuar dhe aktivizuar rezervat më efçente në kosto.
4. OST sha do të zbatojë një model të vetë-dispeçerimit për përcaktimin e skeduleve të gjenerimit dhe të konsumit.
5. OST sha ka të drejtën të refuzojë Ofertat e Kapaciteteve që nuk janë në përputhje me rregullat dhe detyrimet e përcaktuara në Rregulla e Tregut Shqiptar të Balancimit dhe në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në kete Marrëveshje.
6. Në rast se OST vë re një sjellje të OSHB e cila mund të çënojë Rregullat e Tregut dhe/ose konkurrencën e drejtë midis palëve, pasi është konsultuar me ERE dhe Autoritetin e Konkurences, OST sha rezervon të drejtën të përjashtojë OShB nga prokurimet e ardhshme.
7. Vëllimi i plotë i nevojshëm i rezervës balancuese sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe ketyre rregullave prokurohet me bazë tregu, në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.

Neni 5

Detyrimet dhe te Drejtat e Ofruesit të shërbimit të balancimit.

1. Ofruesi i shërbimit të balancimit ka detyrimin të sigurojë shërbimin e balancimit për OST sh.a., në sasinë dhe kohën e kërkuar nga OST sh.a. dhe të konfirmuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

2. Ofruesi i shërbimit të balancimit duhet të vendosë në dispozicion të OST kapacitetet rezervë në ngritje dhe/ose ulje, bazuar në sasinë e kontraktuar në avancë nga OST nëpërmjet ankandeve përkatëse.
3. OShB do të informojë OST, sa më shpejt që të jetë e mundur, për çdo ndryshim në disponueshmërinë ekzistuese të njësive të tij teknike.
4. Ofruesi i shërbimit të balancimit me kapacitet rezervë të kontraktuar duhet të ofrojë disponueshmërinë për aktivizimin e energjisë balancuese dhe duhet të aktivizohet vetëm me kërkesë të OST sh.a. dhe për qëllim të balancimit të sistemit elektroenergetik shqiptar.
5. Kur OST e kërkon, OSHB kane detyrimin për të ulur ose rritur rezevën për të cilën OST ka dijeni që ata e disponojnë, por që nuk e kanë ofertuar për çfarëdo lloj arsye. Gjeneruesit në fjalë do të marrin automatikisht çmimin e disbalancës për kontributin e tyre, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së OShB.
6. OShB që merr pjesë në ankandin për kapacitet balancues duhet të paraqesë dhe do të ketë të drejtën të përditësojë ofertat e tij për kapacitet balancues përpara kohës së mbylljes së portës së procesit të prokurimit.
7. OSHB nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ankand me kapacitet të cilin nuk e disponon. Nëse nga OST konstatohen raste të tilla do të raportohen nga OST në ERE për marrjen e masave sipas kuadrit ligjor në fuqi.
8. Sasinë e kontraktuar në avancë nga OST nëpërmjet ankandeve përkatëse, OSHB nuk mund ta perdorë në rregullimin e kontratave të tjera edhe kur ky kapacitet nuk kërkohej të aktivizohet nga OST.

Neni 6

Procedura e nënshkrimit të aneksit/eve

1. Përmes një platforme të përbashkët ose mjeti tjetër të miratuar, OST do t'i ofrojë OShB një raport lidhur me të dhënat dhe monitorimin e disponueshmërisë së kapacitetit balancues dhe shpërndarjen e energjisë balancuese. Një raport mujor përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë përmban shumën e të gjitha kompensimeve për kapacitetet e kontraktuara dhe energjitë e aktivizuara. Pjesa e dytë përmban të gjitha reduktimet e kompensimeve të llogaritura nga OST, duke treguar gjithashtu metodën e llogaritjes dhe të gjitha të dhënat mbi të cilat bazohet llogaritja.
2. OST , do t'i dorëzojë me postë ose dorazi shitesit 1 (një) kopje të aneksit të nënshkruar në mënyrë të ndërsjellë.
3. Aneksi do të hyjë në fuqi me nënshkrim të ndërsjellë të tij.

Neni 7

Kontrolli, monitorimi dhe testimi

1. Aktivitetet e kontrollit monitorimit dhe testimit për njësitë gjeneruese, që do të marrin pjesë në sigurimin e shërbimeve balancuese dhe monitorimi i kapacitetit rezervë do të bëhet nëpërmjet sistemit SCADA dhe sistemeve të telematjes që administrohen nga OST sh.a.
2. Testimi i aftësisë për Rezervën Primare FCR dhe Sekondare FRR (LFC):
3. Testimi i aftësisë për të venë në dispozicion Rezervën Primare FCR dhe Sekondare FRR (LFC) kryhet në mënyrë të detyrueshme nga OST-ja.
4. Ky testim kryhet në mënyrë periodike në kohë reale nga Operatori i Sistemit nëpërmjet instalimeve SCADA dhe të telematjes, në korrelacion me veprimtarinë e kontrollit dhe mbikqyrjes për operimin e njësive gjeneruese.
5. Në qoftë se nga testimi i njësive gjeneruese rezulton që parametrat e testuar për këto rezerva nuk i përgjigjen parametrave të deklaruar dhe të kualifikuar, atëherë OSHB duhet të përgatisë për OST brenda 5 ditëve një raport të detajuar, duke specifikuar arsyet dhe masat që duhen marrë.
6. Nëse devijimet janë të mëdha dhe të pakorrigjueshme, propozohet rishikimi i marrëveshjes midis OST dhe OSHB.
7. OST sh.a ka të drejtën të vlerësojë, në çdo kohë gjatë periudhës së vlefshmërisë së Marrëveshjes së OSHB, nëse OSHB është apo jo në pajtueshmeri me termat dhe kushtet e përmendura në këtë Marrëveshje të OSHB.

Neni 8

Matja dhe faturimi i shërbimit të balancimit

1. Disponueshmëria e kapacitetit rezervë të kontraktuar do të monitorohet nga OST dhe do të faturohet në varësi të ofertës së dhënë nga OSHB.
2. Energjia Balancuese e aktivizuar do të rezultojë nga matja e energjise për cdo PSHD, duke konsideruar vlerën e nominuar në periudhën perkatese, kërkesën për rregullim të bërë nga ana e OST nëpërmjet sistemit SCADA dhe do të faturohet me çmimin e rezultuar nga tregu balancues, në përputhje me statusin e balances së sistemit për cdo PSHD.
3. Në rast se OSHB nuk bën aktivizimin e rezervës balancuese (nuk reagon, aktivizon me pak se 70% të kërkesës për rregullim, apo bën levizje në drejtim të kundërt), brenda intervalit të kapacitetit të kontraktuar për cdo PSHD, në ndjekje të kërkesës së OST për rregullim, që evidentohet dhe pasqyrohet (konfirmohet) nga ana e OSHB nëpërmjet sistemit SCADA, atëherë diferenca ndërmjet aktivizimit të rezervës balancuese të bërë nga OSHB dhe kërkesës për rregullim të bërë nga OST, do të trajtohet si disbalance e OSHB për periudhën perkatese.
4. Nëse raste të tilla perseriten me shume se një herë OST sh.a raporton rastin në ERE dhe kërkon marrjen e masave referuar dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 9

Faturimi dhe pagesa

1. **Fatura:** Shitësi në bazë të faturës pro-forma do t'i dorëzojë Blerësit një faturë sipas formatit dhe standardeve që kërkon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasitë totale të Energjisë Elektrike dhe Kapacitetit të shitur prej tij në periudhen kohore prej një muaji të levrimit të miratuar në Aneksin përkatës të kësaj kontrate. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e fundit të çdo muaji. (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës).
2. **Fatura pro-forma:** Për çdo vëllim të angazhimit mbi disponueshmërinë të dhënë, OShB do të marrë një konfirmim të kërkesë/ofertës duke deklaruar numrin e kërkesë/ofertës së blerjes dhe kompensimet për Kapacitetin Rezervë të kontraktuar (rezervimi). Brenda tri ditëve pune pas përfundimit të muajit, OShB mbledh vlerat nga raportet ditore dhe dërgon në departamentin e shlyerjes të OST faturën pro-forma mujore të tij për kapacitetin balancues të kontraktuar dhe energjinë balancuese të shpërndarë. Brenda 5 ditëve pune pas marrjes së faturës pro-forma, OST do të pranojë ose refuzojë atë.
3. **Pagesa:** Blerësi do t'i kryejë pagesën Shitësit kundrejt vlerës së faturës sipas pikes 1. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e fundit e livrimit. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.
4. **Vonesa në kryerjen e pagesës;** Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse palët dështojnë të kryejnë pagesat brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë ai i parashikuar në Ligjin 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare" i ndryshuar.

Neni 10

TVSH-ja dhe taksat

1. **TVSH-ja:** Të gjitha shumat e referuara në këtë Kontratë përjashtojnë çdo vlerë të zbatueshme të taksës së shtuar ("TVSH"). Nëse TVSH-ja është e pagueshme për çdo shumë të tillë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një shumë të barabartë me TVSH-në me tarifën e zbatueshme. Një shumë e barabartë me TVSH-në e pagueshme nga një Palë do të kërkohej për t'u paguar vetëm kur Pala tjetër të sigurojë një faturë të vlefshme TVSH-je lidhur me atë shumë. Çdo Palë, për aq sa e lejon ligji, do t'i sigurojë palës tjetër fatura TVSH-je shtesë të vlefshme që kërkohej për qëllimet e Kontrates.
2. **Detyrimet e Taksave të Shitësit dhe Blerësit:** Shitësi do të paguajë ose sigurojë pagesën e gjithë Taksave për Sasinë e Kontratës ose lidhur me të që del para transferimit të riskut dhe titullit në Pikën e Livrimit. Blerësi do të paguajë ose do të kryejë pagesën e gjithë Taksave në Sasinë e Kontratës ose lidhur me të që dalin gjatë ose pas transferimit të riskut dhe titullit në Pikën e Livrimit (përveç Taksës direkte ose indirekte që lidhet me shitjen e Sasisë së Kontratës

dhe është përgjegjësi ligjore e Shitësit). Në rast se Shitësit i kërkohet me ligj të paguajë çdo Taksë të përshtatshme për llogarinë e Blerësit, Blerësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë Shitësin për këtë Taksë. Në rast se Blerësit i kërkohet me ligj të paguajë çdo Taksë të përshtatshme për llogarinë e Shitësit, Blerësi mund të kërkojë nga shitësi ta zbresë shumën e kësaj Taksë nga shumat që i detyrohet Shitësit sipas Kontratës, në të kundërt Shitësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë Blerësin lidhur me këto Taksa të pazbritura. Nëse ndonjë Taksë e re bëhet e zbatueshme ose një Taksë ekzistuese rritet lidhur me Kontratën dhe Blerësi është në gjendje ta kalojë përmes një pale të tretë, Blerësi do të jetë përgjegjës për këtë Taksë të re ose të rritur.

3. **Taksa e Mbajtur: Pagesat Lirë dhe Qartë.** Gjithë pagesat sipas Kontratës do të bëhen pa mbajtje ose zbritje për llogari të çdo Takse përveç kur kjo mbajtje ose zbritje kërkohet me ligj. Nëse një Pale i kërkohet të mbajë ose zbresë Taksën nga një pagesë që duhet të bëjë, atëherë ajo Palë ("**Pala Pague**se") do të njoftojë menjëherë Palën tjetër ("**Pala Marrë**se") për këtë kërkesë dhe do t'u paguajë autoriteteve të duhura gjithë shumat e mbajtura ose të zbritura prej saj. Nëse mund të lëshohet një faturë ose provë tjetër që evidenton pagesën tek autoritetet, Pala Pague se do t'ia dorëzojë këtë provë (ose një kopje të certifikuar) Palës Marrëse.
4. **Minimizimi i Taksave:** Të dyja Palët do të përdorin përpjekje të arsyeshme për të administruar Kontratën dhe për të zbatuar dispozitat e saj sipas synimit për minimizimin e akumulimit të detyrimeve për pagesën e Taksës, kur është e arsyeshme dhe e mundur.

Neni 11

Mos-Performanca për Shkak të Forcës Madhore

1. Përveç se kur specifikohet ndryshe në këtë kontratë, "Forca Madhore" për qëllimet e kësaj kontrate do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të një pale që e pengon atë palë të realizojë disa ose të gjitha detyrimet e kësaj kontrate. Ngjarjet e forcës madhore do të përfshijnë pa kufizim:
 - a) një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë secilën palë të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të një pale dhe nuk ndodhin për faj të saj dhe që pala nuk është në gjendje t'i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e saj, si dhe rastet e parashikuara nga neni 90 i Ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".
2. Nëse një palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për lëvrim dhe pranim sipas kësaj kontrate dhe kjo pale respekton kërkesat e pikës 13.3 të këtij neni, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet nga këto detyrime për atë periudhë kohore që

kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet **(Zhdëmtimet për Paaftësinë për Lëvrim dhe Pranim)** nuk do t'i kërkohej dhe merret Palës lidhur me sasitë e palëvruara respektivisht të pa marra si rezultat i Forcës Madhore.

3. Sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi konstaton Forcën Madhore Pala që kërkon përjashtim nga detyrimet e veta, do të njoftojë Palën tjetër për ngjarjen e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet ekonomikisht të favorshme dhe të ligjshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimit të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër të dhëna të përditësuara, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese

Neni 12

Zgjidhje e Mosmarrëveshjeve dhe Ligjet e Zbatueshme

1. Për çdo gjë të pashprehur në këtë kontratë, palët do të referohen dispozitave të legjislacionit që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike.
2. Kjo kontratë do të zbatohet në përputhje me të gjitha aktet normative me fuqi juridike në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Në rast të lindjeve të mosmarrëveshjeve gjatë zbatimit të kësaj kontrate, Përfaqësuesit e autorizuar për çdo Palë, do të tentojnë me mirëbesim të zgjidhin mosmarrëveshjen sa më shpejt që të jetë e mundur. Në qoftë se Përfaqësuesit arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen, zgjidhja do t'iu njoftohet Palëve me shkrim dhe do të jetë detyruese për ato. Në qoftë se Përfaqësuesit nuk mund ta zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një afati kohor të arsyeshëm por jo më të gjatë se 40 (dyzetë) dite kalendarike, ose në qoftë se një Palë nuk arrin të zgjedhë një përfaqësues, brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike nga njoftimi me shkrim i ekzistencës së mosmarrëveshjes, atëherë secila prej Palëve ka të drejtë t'i drejtohet ERE-s, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
4. Secila palë ka të drejtë që, që nga dita që ka marrë njoftim për vendimin e ERE-s, t'i drejtohet gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 13

Ndryshimet

1. Kjo kontratë mund të ndryshohet vetëm me një dokument të shkruar të firmosur nga të dyja Palët dhe të miratuar nga ERE.

Neni 14

Klauzola Përfundimtare

1. Palët bien dakord që:

- a) do të ndërmarrin të gjitha veprimet që janë të arsyeshme, në mirëbesim dhe të nevojshme për të siguruar vijimësinë e shërbimit dhe aplikimit të kësaj Kontrate;
- b) do të negociojnë dhe të rishikojnë këtë Kontratë kur është e nevojshme për tu përshtatur me të gjitha ndryshimet në aktet normative me fuqi juridike në territorin e Republikës së Shqipërisë; dhe
- c) përveç rasteve kur përshkruhet ndryshe në këtë Kontratë të ruajnë siç parashtrohet në këtë kontratë, të mos e ndërpresin ose të pezullojnë përmbushjen e ndonjë detyrimi si rezultat i ndonjë vendimi në pritje për ndonjë debat ndërmjet palëve.

Neni 15

Personat e Kontaktit

Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme me email ose faks:

Z/Znj _____

Funksioni:

Adresa....., Tiranë

Tel.:

Mob:

E-mail:

Fax:

Z/Znj _____

Funksioni:

Adresa....., Tiranë

Tel.:

Mob

E-mail:

Fax:

Neni 16

Të ndryshme

1. **Njoftimet dhe Komunikimet:** Përveç kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga Palët, gjithë njoftimet, deklaratat ose faturat e dërguara nga një Palë tjetër duhet të jenë me shkrim dhe duhen dorëzuar me letër (postë që arrin brenda 24 orësh ose korrier, postë e parapaguar) ose faksimile. Çdo Palë mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit me anë të një njoftimi me shkrim palës tjetër. Njoftimet me shkrim, deklaratat dhe faturat do të konsiderohen si të marra dhe efektive:

- a) nëse shpërndahen dorazi Ditën e Punës, ose Ditën e parë të Punës pas datës së livrimit nëse shpërndahen jo në Ditën e Punës;
 - b) nëse dërgohen me postë të shpejtë, Ditën e 2 të Punës pas datës së postimit, ose nëse dërgohen nga një shtet në tjetrin, në Ditën e 5 të të Punës pas datës së postimit;
 - c) nëse dërgohen me transmetim faksimile dhe prodhohet një raport i vlefshëm transmetimi që konfirmon marrjen, ditën e transmetimit nëse është transmetuar para orës 17.00 (me orën e marrësit) në Ditën e Punës ose në orën 09.00 (me orën e marrësit) në Ditën e parë të Punës pas transmetimit.
2. **Amendimet:** Çdo amendim ose shtesë në këtë Kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët.
3. **Pavlefshmëria e Pjesshme:** Nëse, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, në çdo drejtim, sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Kontrate, nuk do të preken ose dëmtohen në ndonjë mënyrë. Palët ndërmarrin zëvendësimin e çdo dispozite të paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme me një dispozitë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme që afrohet sa më shumë me dispozitën e pavlefshme lidhur me qëllimin e saj ekonomik, subjekt i aprovimit sipas pikes 2.
4. **Të Drejtat e Palës së Tretë:** Palët nuk presin që ndonjë palë e tretë të ketë të drejta ose të jetë e aftë të zbatojë Kontratën dhe Palët përjashtojnë për aq sa është e lejueshme nga legjislacioni në fuqi, çdo të drejtë të këtyre palëve të treta që mund të nënkuptohet.

Neni 17

Hyrja ne Fuqi dhe afati i zbatimit te Kontrates

Kjo kontratë do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga të dy Palët.

Kontrata bëhet ne tre kopje origjinale, një për shitësin dhe dy për OST sh.a.

Për dhe në emër të OST sha.

Për dhe në emër të [Emri i Kompanisë]

Skerdi Drenova

[Emër Mbiemër]

Administrator

[Pozicioni]

Nënshkrimi: _____ Datë: __/__/__

Nënshkrimi: _____ Datë: __/__/__

Shtojca 1. Kapaciteti Rezervë

Prokurimi i kapacitetit rezervë për qëllime të balancimit të sistemit

Datë: __/__/__

Kapaciteti Rezervë i Kontraktuar	[FCR/aFRR/mFRR/RR]
Drejtimi i rregullimit	[rritje/ulje]
Periudha e kontraktimit	Nga __/__/__ deri më __/__/__

Intervali kohor	Sasia e kontraktuar [MW]	Çmimi i kontraktuar [Euro/MW]	Vlera [Euro]
1 (00:00 - 01:00)			
2 (01:00 - 02:00)			
3 (02:00 - 03:00)			
4 (03:00 - 04:00)			
5 (04:00 - 05:00)			
6 (05:00 - 06:00)			
7 (06:00 - 07:00)			
8 (07:00 - 08:00)			
9 (08:00 - 09:00)			
10 (09:00 - 10:00)			
11 (10:00 - 11:00)			
12 (11:00 - 12:00)			
13 (12:00 - 13:00)			
14 (13:00 - 14:00)			
15 (14:00 - 15:00)			
16 (15:00 - 16:00)			
17 (16:00 - 17:00)			
18 (17:00 - 18:00)			
19 (18:00 - 19:00)			
20 (19:00 - 20:00)			
21 (20:00 - 21:00)			
22 (21:00 - 22:00)			
23 (22:00 - 23:00)			
24 (23:00 - 00:00)			

Shtojca 2. Energjia Balancuese

Prokurimi i energjisë balancuese për qëllime të balancimit të sistemit

Datë: __/__/____

Produkti i aktivizuar	[FCR/aFRR/mFRR/RR]
Drejtimi i rregullimit	[rritje/ulje]
Periudha e kontraktimit	Datë __/__/____ (00:00 – 24:00)

Intervali kohor	Sasia e aktivizuar [MWh]	Çmimi i energjisë balancuese [Euro/MWh]	Vlera [Euro]
1 (00:00 - 01:00)			
2 (01:00 - 02:00)			
3 (02:00 - 03:00)			
4 (03:00 - 04:00)			
5 (04:00 - 05:00)			
6 (05:00 - 06:00)			
7 (06:00 - 07:00)			
8 (07:00 - 08:00)			
9 (08:00 - 09:00)			
10 (09:00 - 10:00)			
11 (10:00 - 11:00)			
12 (11:00 - 12:00)			
13 (12:00 - 13:00)			
14 (13:00 - 14:00)			
15 (14:00 - 15:00)			
16 (15:00 - 16:00)			
17 (16:00 - 17:00)			
18 (17:00 - 18:00)			
19 (18:00 - 19:00)			
20 (19:00 - 20:00)			
21 (20:00 - 21:00)			
22 (21:00 - 22:00)			
23 (22:00 - 23:00)			
24 (23:00 - 00:00)			